

Komunikimi medial në shoqërinë postkonfliktuale

*Ibrahim Berisha**

Përmbledhje

Nga ish-Jugosllavia, që filloi të shkatërrohej në vitin 1990, u krijuan shtatë shtete të reja. Shoqëritë e këtyre vendeve kaluan nëpër stadi lufte dhe periudha postkonfliktuale. Mediet dhe gjuha publike e përdorur në to ishte pjesë dinamike e konflikteve dhe postkonflikteve. Kosova është shteti më i ri (17 shkurt 2008), që kaloi nëpër një proces lufte dhe eksodi masiv, pastaj edhe nëpër një proces tranzicioni paqësor postkonfliktual. Modeli *Mediet e paqes* ishte pjesë e këtij tranzicioni, i cili ende nuk ka përfunduar, ashtu siç nuk ka përfunduar as ndërtimi i demokracisë politike. Shpesh zhvillohen debate për temën e përgjegjësisë që i faturohet për konfliktet, në njërin anë dhe në tjetrën, për rolin pozitiv që luan media dhe gazetarët në shoqëritë postkonfliktuale. Cila ishte gjuha publike që shoqëroi luftërat dhe cila gjuhë shoqëroi ndërtimin e shoqërive demokratike?

Fjalët kyç: periudha postkonfliktuale, mediet dhe gjuha publike, mediet e paqes, tranzicioni, parlamentarizëm, tele-revolucioni, tele-diktatura, getoizimi medial.

Në fund të viteve '80-të të shek. XX, në ish-Jugosllavi, kriza sociale dhe politike ndikoi në ndryshimin e gjuhës së komunikimit publik. Destabilizimi politik dhe social përfshiu të gjitha njësitë federale, duke mos lejuar krijimin e institucioneve, të cilat do të dilnin nga procesi *legal* i ndryshimit të sistemit

* Prof. ass. dr. Ibrahim Berisha, Fakulteti Filozofik, Departamenti i Sociologjisë, Universiteti i Prishtinës, Universiteti AAB, Republika e Kosovës, Iberisha5@hotmail.com

politik. Bazat e një shoqërie dhe të një sistemi të ri u shkatërruan për shkak të konflikteve dhe aspiratave dominuese të nacionalizmit serb, që prodhuan paqëndrueshmëri dhe luftëra me pasoja tragjike për këtë rajon. Në këtë gjendje të rivalitetit ekstrem për dominim dhe hegjemonizëm etnik, retorika mbizotëruese ideologjike komuniste, që ishte formale për 40 vjet, u zëvendësua nga gjuha joformale dhe nga retorika nacionaliste. Kalimi nga komunizmi në parlamentarizëm ishte edhe më i vështirë sesa në shtetet e tjera të bllokut të lindjes.

Luftërat që u zhvilluan në ish-Jugosllavi (1990-1999), vetëm sa inkurajuan përdorimin e gjuhës së mllëfit, të së kaluarës dhe të nxitjes së nacionalizmave lokalë. Mediet ishin mjete aktiv çorientues i qytetarit të zakonshëm, sepse dëshira për të pasur informacione dhe të reja që u ishin ndaluar për katër decaie, i bënte ata të mos jenë plotësisht kritikë në konsumimin e prodhimi medial që u ofrohej. Varfëria dhe fatkeqësia e qytetarit nuk kërkohej në politikat e gabuara dhe në medien si lansuese të gjuhës së korruptuar politike, por te populli tjetër, te grupi tjetër etnik. Kjo atmosferë përshkruhet si keqpërdorim i "lirisë së shprehjes" dhe kjo vërehet edhe në analizat që i janë bërë kësaj atmosfere komunikimi nga studiuesi kroat Rora. Ai shprehet se "polarizimi në mediet tona dhe politikat e rrezikshme mediale kanë bërë që të krijohet një mendim i gabuar se mund të shkruhet dhe të thuhet gjithçka, të krijohet një atmosferë gjoja e lirë e komunikimit, e cila në të vërtetë as që ka ekzistuar dhe as që ekziston tani".¹

Propaganda mediale nga Beogradi bëhet më e fuqishme para dhe gjatë luftërave në Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë dhe në Kosovë. Virtyti qytetar humbet, ndërsa energjia transformuese orientohet në mobilizim militar. Sulmet e ushtrisë serbe, krahas politikës, i motivon posaçërisht Televizioni Publik i Serbisë-RTS, Agjencia e lajmeve "Tanjug"[...].² Adhurimi për vetveten dhe refuzimi për të gjithë të tjerët, mbërrihet përmes politizimit komunitar (etnik). Titujt dhe artikujt me shkrime agresive

¹ Ivan Rora: "Mediji i demokracija", Dom i Svijet, nr. 229, Qendra Kroate e Informacionit, Zagreb, 1999.

² Tanjug është agjencia shtetërore e lajmeve e krijuar nga komunistët jugosllavë më 5 nëntor 1943.

vërshojnë medien në Beograd. Në një lajm të agjencisë shtetërore "Tanjug", të njohur për ngarkesën e regjimit totalitar, gjenden dy cilësorë negativë për shqiptarët: "tregtarët e ndershëm shqiptarë (albanci)" të cilët nuk "kanë dashur t'i mbyllin shitoret në Pejë, dhe pastaj u janë thyer vitrinat" (kupto: me të drejtë nga serbët) dhe "shiptarkat" që demonstrojnë duke kërkuar "përkrahje ndërkombëtare". Kështu "albanci" përdoret në kuptimin pozitiv, ndërsa termi "shiptar" në kuptimin fyes, nënçmues, që në të vërtetë është të folur i vjetër. "Disa gazeta në Beograd me vite kanë shkruar fjalën "shiptar" me "s" të vogël".³

Gjuha e urrejtjes, si model publik komunikues dhe kulturor, e bën urrejtjen "normale" dhe pjesë të përditshmërisë.⁴ Ndalja në zbërthimin e politizimit ekstrem të shtypit serb, është e lidhur edhe me rolin afatgjatë të tij për të paralizuar mendimet alternative. RTS, gjatë dhjetë vjetësh jo vetëm kreu rolin kryesor të propagandës luftënxitëse në qendër, por përfshiu edhe rrjetin e tij të shtrirë në terren, me radio dhe televizione lokale. Pozicionimi i medieve serbe në favor të luftës homogjenizoi "vetëdijen kombëtare" e në anën tjetër i bëri të paefektshme mekanizmat e kontrollit social.

Është e qëndrueshme teza se pas tele-revolucionit në fund të viteve '80 të shekullit të kaluar, mediet shtetërore serbe krijuan tele-diktaturën, përkatësisht mediumin e vetëm për luftën, nevojën që ajo të bëhej, sepse konsiderohej të ishte e denjë dhe, si e tillë, e vetmja rrugë për të pasur një rezultat dhe ardhmëri për popullin serb. Gjuha e urrejtjes, si zgjerim i propagandës së luftës, angazhimi për likuidimin e kundërshtarëve politikë, përhapja e urrejtjes nacionale, fetare dhe llojeve të tjera të mosdurimit, që është një praktikë e shteteve totalitare, ishin përmbajtje dominuese e medieve të këtij regjimi. Gazetarët, që është edhe më keq, jo vetëm që ndihmuan që njerëzit të vriten, por në një mënyrë ata vetë ishin vrasës.⁵ Frika ndryshoi edhe etikën profesionale, për të ndikuar që të mos kishte kurrfarë

³ Milos Vasiq: "Jezik mrznje u zvanicnim medijima", SE, 15 nart/ozuljak 1998.

⁴ Miroljub Radojkovic: Media Transition in Srbija', doc. 2000 (Media online).

⁵ Mirko Galiq, Arhiva, Sarajevo, 2000 (bot. elektronik www.aimpress.ch).

solidariteti nga organizatat profesionale në kohën e ndjekjeve, likuidimeve dhe gjykimeve të gazetarëve të pavarur.

Ky prelud për modelin komunikues autoritar, mund të vihet edhe në funksion të shpjegimit të gjuhës komunikuese mediale në republikat e tjera të ish-Jugosllavisë. Në emër të kundërpropagandës serbe, gjatë periudhës së paraluftës dhe luftës, edhe në mediet e popujve joserbë favorizohet folklori patriotik, gjuha patetike dhe krenaria komunitare (etnike).

Në këtë konstelacion ndryshimesh komunikuese, rasti i Kosovës shquhet me të veçanta, krahasuar me ish-republikat e Jugosllavisë, ngase mediet ishin nën presionin e shtetit serb që nga viti 1990. Ndërsa në Kroaci dhe në Bosnjë para, gjatë dhe pas agresionit serb, u ruajtën mediet nacionale, në gjuhën kroate dhe në atë boshnjake, duke ruajtur edhe mundësinë e komunikimit aktiv qeveri - qytetarë, një gjë e tillë nuk ishte e mundur në Kosovë. Shqiptarët nuk kishin medie elektronike dhe as që kishte mundësi për impakte nacionale dhe tejnacionale mediatike, për shkak të infrastrukturës së transmetuesve të kontrolluar nga regjimi i dhunshëm. Këtu është i nevojshëm një sqarim më i detajuar për të pasur informacionin se si ndodhi që mediet në gjuhën shqipe në Kosovë, që kishin transmetuar program 40 vjet, të mbylleshin pas ndërhyrjes arbitrare policore të regjimit serb.

Mediet e Kosovës funksionuan në pajtim me ligjet e ish-federatës së Jugosllavisë deri në vitin 1990. Kosova me kushtetutën e miratuar në vitin 1974, ishte njëra nga tetë njësitë federale dhe mbështetur në këtë kushtetutë, gëzonte të drejtën e funksionimit të medieve autonome, një qendër radiotelevizive me rrjetin lokal të radiove. Mbi këtë model ishin ndërtuar edhe sistemet e tjera mediale në shtatë njësitë e tjera federale. Në vitin 1990, ndërhyrja ushtarake dhe policore e regjimit të Millosheviqit në Kosovë, pasoi mbylljen e institucioneve edhe në fushën e medias.⁶

⁶ Radio Televizioni i Prishtinës, ose RTP, ishte radio televizioni i parë shqiptar i Kosovës. Emetimi i programeve nga ky televizion u ndërpre me masa të dhunshme nga qeveria serbe në vitin 1990. Radio Prishtina filloi punën pas Luftës së Dytë Botërore, më 1945.

Ndalohet gjuha shqipe në medien e vetme publike televizive, megjithëse 92 për qind e popullsisë ishin shqiptarë. Media multientike RTP (Kosovë) që transmetonte program në gjuhën shqipe, serbe, turke dhe rome, shndërrohet në media të regjimit të Millosheviqit, duke edituar program vetëm në gjuhën serbe. Gjuha dhe sistemin i komunikimit dominohej nga fyerjet, nënçmimi dhe propaganda ekstreme kundër shqiptarëve, kulturës, gjuhës dhe identitetit të tyre. Nëntë vjet RTK (1990-1999), si “medium publik” në Prishtinë lansoi përmbajtje mediale kundër popujve joserbë, ringjalli mitet mesjetare, me afeksion përjashtimi dhe nxiti konflikte që kishin synim ngritjen e “frymës luftarake të nacionit serb” si “viktimë e të gjithë fqinjëve”.

Shoqëria kosovare kështu ishte rast i posaçëm edhe në transformimin e medias, dhe nuk mund të kishte procese ku do të dominonte ekuilibri pozitiv. Media në gjuhën e popullsisë shumicë nuk kishte mundësinë të prodhojë informacione alternative. Getoizimi medial synoi ndërprerjen e komunikimeve në gjuhën shqipe jo vetëm në kufijtë e vjetër politik, por edhe ata kulturorë dhe gjuhësorë. Pra, media në Kosovë nuk e pati rastin e ngjashëm me mediet në shoqëritë posttotalitare, për të ndjekur një proces transformimi që nuk ishte i lehtë edhe në vendet e tjera, mirëpo edhe ato shtete që kaluan më shpejt periudhën e konflikteve nacionaliste, mediet nuk u kursyen nga konfliktet e forta ndërmjet vetë grupeve politike, shteteve brenda shteteve”.⁷

Gjatë viteve 1998 -1999 ishte agresioni ushtarak i Serbisë që shkaktoi vrasjen e mbi 14 mijë njerëzve dhe shkatërrimin e mbi 70 mijë objekteve të banimit dhe duhej përgjigje pragmatike, se cili do të ishte modeli komunikues, veçmas me pakicën serbe që ishte në masë të madhe e identifikuar me veprimet e ushtrisë dhe policisë në këtë luftë.

Politika që u zbatua nga shqiptarët dhe ndërkombëtarët mbas 12 qershorit të vitit 1999 ishte një shmangie nga arbitrariteti dhe u përdor adoptimi i politikave jokonfrontuese. OSBE, organizata ndërkombëtare që stimulon zhvillimin e

⁷ Doc. “Rasti i Evropës Juglindore - Mediet në tranzicion”, Lubjanë, 2002.

politikave mediale dhe të demokracisë, bashkë me administratën civile ndërkombëtare UNMIK-n, adoptoi politika të ndërtimit të *medies së paqes*. Ky nocion u bë identifikues i gjuhës publike politike dhe mediale në Kosovë. Shoqëria që doli nga një luftë me pasoja të rënda, instaloi gjuhë diametralisht të kundërt me gjuhën e përdorur më parë nga mediet serbe në Kosovë. Mediet në Kosovë u kthyen në një gjenerator tolerance dhe mirëkuptimi në vend të nxitjes së urrejtjes dhe dhunës. Shoqëria e Kosovës nën administrimin e OKB-së dhe nën sigurinë ushtarake të NATO-s rregullohet mbi tre shtylla: multientitetet i synuar, traditë plurale fetare dhe standarde evropiane të lirive.⁸ Mbas vitit 1999, përmes donacioneve ndërkombëtare u ndërtua rrjeti dinamik i medieeve elektronike dhe i shtypit. Në fund të vitit 2001, në Kosovë ishin të paraqitura për punë 48 radio në gjuhën shqipe, 22 radio në gjuhën serbe, nga 2 radio në gjuhën turke dhe boshnjake dhe tri radio në gjuhën rome. Përpos radiove të paraqitura për të transmetuar emisione në një gjuhë, në Kosovë, veçmas nëpër komuna të përziera ku krahas shqiptarëve jetojnë edhe minoritetet, punonin radiot në dy e tri gjuhë: 2 radio në gjuhën shqipe dhe serbe, 2 radio në gjuhën shqipe, serbe dhe turke, 2 radio në gjuhën shqipe dhe boshnjake, 1 radio në gjuhën shqipe, serbe dhe rome, një radio në gjuhën shqipe dhe gorane, 1 radio në gjuhën shqipe dhe turke, 2 radio në gjuhë serbe dhe rome.⁹ Po ashtu emetojnë program 15 televizione në gjuhën shqipe, 6 në gjuhën serbe, 1 në gjuhën shqipe, serbe dhe turke dhe 1 në gjuhën shqipe-boshnjake dhe turke.¹⁰

Numrit kaq të madh të medieeve elektronike që fillojnë punën në Kosovën e mbas luftës, në të gjitha gjuhët e folura nga grupe entike, mund t'i gjendet arsytimi. Kërkohej një bashkërendim komunikues i qendrave të pushtetit, në këtë rast ndërkombëtarët me qytetarët, dhe në anën tjetër edhe të qendrave politike lokale, me qytetarët. Kjo gjuhë duhej të mbështetej në strukturat e realitetit të Kosovës, dhe ky realitet

⁸ Milazim Krasniqi: "Në çfarë Kosove do të jetojmë", *Zëri ynë*, Prishtinë, 2008, f.215.

⁹ Raport TMC The Kosovo temporary media commissioner (report 2000-2001), Prishtinë 2002.

¹⁰ Po aty.

ishte ende konfuz. Për këtë shkak, prioritet ishte e ardhmja dhe jo e kaluara. Gjuha komunikuese megjithëse nuk do të mbështetej në lirinë e plotë, ajo do të bazohej në kufij të ri politik dhe të përgjegjshëm.

Megjithëse vetëm gjashtë për qind serbë, ata kishin shumë më tepër radio dhe televizione në raport me shqiptarët, si popull shumicë dhe popull që ishte viktimë e luftës. Toleranca ndaj serbëve u kodifikua si kategori orientuese e komunikimit publik të shumicës ndaj pakicës në Kosovë. Të drejtat individuale dhe kolektive megjithëse më shumë funksionuese mbi parimin mekanik, ato megjithatë siguruan të drejta të pacenueshme komunikimi në gjuhët e qytetarëve me përkatësi të ndryshme etnike.

Për të sqaruar më thellë mënyrën e krijimit të një medie të fuqishme të paqes në një vend postkonfliktual, siç ishte Kosova, jep shembull rasti i RTK (Radio Televizioni i Kosovës). RTK është medium publik i krijuar me ndihën financiare, teknologjike dhe profesionale të bashkësisë ndërkombëtare. OSBE, përmes Unionit Evropian të Transmetuesve - EBU, fillon me një shërbim emergjent medial, që kishte për qëllim programor transmetimin e informacione të para në një vend që ende ishte i shkatërruar nga lufta dhe pasojat do të ndihen në një periudhë afatgjate.

Në shtator të vitit 1999 RTK-ja, vetëm dy muaj mbas largimit të ushtrisë serbe, nis me një program dy orësh në ditë duke u futur në ambientet e kompanisë së mëparshme mediale RTP, e cila deri në mbarim të luftës, vepronte si medium nën kontrollin serb. Fillimisht ajo është menaxhuar nga EBU-ja me një Memorandum Bashkëpunimi me OSBE-në. Në qershor të vitit 2001, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/13 edhe formalisht ka njohur RTK-në si shërbim publik transmetues. Investimet e mëdha i krijuan avantazh këtij mediumi, i cili u bë burimi kryesor i informacionit për qytetarët. Sondazhet tregojnë se 84% e qytetarëve merrnin informacionin nga televizioni, 8% nga radiot dhe 6% nga gazetat.¹¹

¹¹ IREX: Mediat dhe politika në Kosovë, 2004, f.1.

RTK-ja funksionon edhe sot mbi parimet që "të respektojë veçoritë dhe dinjitetin e njeriut, parimin e paanshmërisë, vërtetësinë e informacionit, pluralizmin e mendimeve si dhe pluralizmin fetar e politik".¹²

Duhet pasur parasysh se në mesin e vitit 2007, RTK transmeton program në gjuhën shqipe dhe njëherësh edhe në katër gjuhë të minoriteteve, të cilat jetojnë në Kosovë - në gjuhën serbe, boshnjake, turke dhe rome. Nëse do të nxirrej një moto e përcaktuar normative lidhur me këtë media, atëherë ajo do të ishte tendenca e saj për të shprehur interesa divergjente politike, pluralizëm gjuhësor, kulturor dhe religjioz.¹³ Politikat programore fokusohen në informimin e balancuar, përmbajtje mediale argëtuese dhe arsimore.

RTK kishte përkrahjen nga audienca lokale, por jo njësoj edhe nga të gjitha institucionet ndërkombëtare që bënë politikën në këtë vend. Një ngjarje në vitin 2004 nxori në pah konfliktin për RTK, ndërmjet financuesve evropianë dhe qendrave të kontrollit të medias (UNMIKU-t, administrata ndërkombëtare e OKB-së). Kjo media u atakua nga pozicionet konjunkturale politike. Komisionari i Përkohshëm Ndërkombëtar, Robert Zhillet, në mars të vitit 2004, pas trazirave që ndodhen dhe që u sulmuan nga demonstruesit pronat e serbëve, akuzoi RTK, si përgjegjëse të shtrirjes së protestave më 16 dhe 17 mars. Pas këtyre ngjarjeve të marsit 2004, RTK-së i rrezikohej edhe mbyllja nga fakti i "akuzës së nxitjes së protestës". Kërcënimi i Komisionarit të Përkohshëm për Media - Zhillet me mbyllje të kësaj media, ndikoi te redaktorët dhe gazetarët të shtohet censura dhe autocensura, si mekanizëm mbrojtës për t'i ikur presioneve dhe kërcënimeve të jashtme. Kërcënimi mbas kësaj ndërhyrjeje u arsyetua politikisht nga drejtuesi i Departamentit të Drejtësisë në OSBE, Margaret Grebe: Rregulloret nuk përfaqësojnë kurrfarë censure, respektivisht ato nuk dallojnë shumë nga kodi i mirësjelljes, për respektimin e të cilit janë të obliguara të gjitha mediet dhe të

¹² Ligji për Radio Televizionin e Kosovës 2006, f.3.

¹³ Po aty.

cilat kërkojnë nga të gjitha mediet të kenë qasje të ndershme dhe objektive, duke mos e përdorur gjuhën e urrejtjes.

Cilat ishin rregulloret me të cilat u mbikëqyr tregu medial në Kosovën e mbasluftës? Do të jetë me interes të preken disa pika, të cilat japin një pamje më të qartë për strukturën, përmbajtjen dhe efektin e këtyre rregulloreve. Madje edhe në Kushtetutën e Kosovës, akti më i lartë juridik, garanton lirin dhe pluralizmin e medias, ndërsa ndalohet censura. Aktet e mëhershme juridike në Kosovë (Korniza Kushtetuese), e ka përcaktuar medien si segment të lirë të shoqërisë, duke precizuar se ajo duhet t'u garantojë komuniteteve pakicë program në gjuhën e tyre. Dokumenti i obligon institucionet që të miratojnë ligje për lirinë e medias, por duke siguruar evitimin e gjuhës së fyerjes dhe urrejtjes.¹⁴

Por, kishte një kontradiktë kundërthënëse ndërmjet Kushtetutës dhe rregulloreve të miratuara për mediet elektronike dhe të shkruara. Rregulloret për mediet dhe e gjithë puna e tyre në Kosovë mbas vitit 1999, i lejonin dhe i kontrollonin institucionet ndërkombëtare. Përfaqësuesi Special i sekretarit të OKB-së në Kosovë, Bernard Kushner, nënshkroi Rregulloren nr. 2000/37, me të cilën bëhet licencimi, kontrolli i medieeve. Pas saj janë krijuar edhe rregulloret të tjera nga Zyra e Komisionerit të Përkohshëm për Media, tani e shndërruar në Komisioni i Pavarur për Media që udhëhiqet nga ekspertë lokalë. KPM i kishte dhënë vetes detyrë të sigurojë që mediet t'i respektojnë të drejtat e njerëzve për shprehje të lirë dhe shumëllojshmëri të opinionëve, për paanësi dhe saktësi, jo vetëm në programe dhe shkrime informative, por edhe në reklama. Kishte të drejtë të zbatojë edhe ndëshkime, të cilat mund të mbërrinin deri në pezullimin e licencës, kur transmetuesi përkundër paralajmërimeve, do vazhdonte me shkelje të përhershme dhe abuzim të transmetuesit. Kur u zyrtarizua kjo Rregullore, motivoi një varg reagimesh, veçmas nga përfaqësuesit e vetë medieeve, të cilat e kanë cilësuar këtë normë si shumë kufizuese dhe cenzuruese.

¹⁴ Korniza Kushtetuse e Kosovës. Kreu 5. Pika 5.4. 15 maj 2001.

Rregulloret dhe ato që u bënë më vonë, tërhiqnin edhe sanksion. Autoriteti vertikal kishte mjetet e mjaftueshme ligjore për të ndërhyrë pa ndonjë procedurë paraprake në media. Neni 3 i Rregullores 2000/37, jep mundësin e gjobitjes së medias deri në 100 mijë marka gjermane, pastaj mund t'i ndalojë lejen e punës për transmetim, t'i marrë pajisjet dhe në fund edhe ta ndërpres krejtësisht transmetimin. Nga pozita e legjitimitetit, problem më vete paraqet neni 5\1 që rregullon një fushë komunikimi publik, duke vënë ndeshë etikën humane me standardet profesionale. Udhëheqësit e radios dhe televizionit do të përmbahen nga emetimi i detajeve personale për ndonjë individ, duke përfshirë emrin e tij, adresën apo vendin e punës në rastet kur një emetim i detajeve të tilla mund të paraqesë rrezik për jetën e atij individi, sigurinë e cilitdo individ, nga personat që e marrin ligjin në duart e veta. Neni 5/1.¹⁵

Ruajtja e qetësisë relative në media ishte gjykuar përmes këtyre neneve, të cilat etikën humane e venin mbi etikën profesionale, veçmas kur bëhet fjalë për ngjarjet që kishin të bënin me luftën dhe individët e implikuar në krimet që ndodhen gjatë zhvillimit të saj. Gazetarët do të ndëshkoheshin bashkë me medien nëse shkruanin jashtë pëlqimit që u kishte dhënë rregullorja kufizuese. Në rastet e shkeljes së këtyre parimeve do të pasojë kërkesa e komisionerit për përgjegjësinë e medias. Komisari i Përkohshëm i Medieve në rrethana të veçanta mund të shpallë rregulla të veçanta, ndërsa Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të shndërrojë në ligj çdo rregull të tillë me anë të urdhëresës administrative, neni 1/2 dhe, në këto raste, imediat nuk kanë ndonjë shkallë reference për ankesë të mundshme. Norma e zbatuar deri në vitin 2007 nuk e jepte mundësin e duhur për gazetarinë kritike dhe kreative.

Si reflektoi kjo normë, duket në rastin e ndalimit të gazetës ditore shqipe "Dita". Polemikë rreth mbylljes së saj edhe sot nuk kanë pushuar plotësisht. Më 27 prill të vitit 2000 Dita botoi artikullin „Kur Petar bëhet Piter“, duke identifikuar punëtorin serb të UNMIK-ut Petar Topolski si pjesëtarë të njësive militare

¹⁵ Doc. Rregullorja 2000/37, Neni 5/1, Prishtinë, 2000.

serbe dhe njëherësh botoi edhe një fotografi me të dhëna personale, si: emrin, adresën, vendbanimin dhe adresën e vendit të punës. Petar Topolski u gjet i vrarë më 15 maj 2000, vetëm pas tri javësh që doli shkrimi në gazetën ditore prishtinase, i cili nuk kishte prejjudikuar fajësinë, por kishte shtuar vetëm faktet materiale: fotografi dhe dëshmitarë në të cilat shihej personazhi i shkrimit në njësitë paramilitare serbe që kishin bërë krime në rrethinën e Prishtinës.

Më 30 maj 2000, Përfaqësuesi Special zbatoi vendimin ekzekutiv për mbylljen e gazetës "Dita". Vendimi urdhëroi mbylljen e gazetës për një kohëzgjatje prej tetë ditësh, bazuar në atë se "Dita" dhe redaktorët e saj e kanë shkelur Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara - 1244\19999.

Më 20 korrik KPM ia dërgoi botuesit të gazetës "Dita" një vendim tjetër në lidhje me një artikull, në të cilin bëhej fjalë për Manastirin e Deçanit,¹⁶ ku priftërinjtë (serbë) kishin pretendime për të bllokuar jetën e banorëve shqiptarë në afërsi të tij. Pas një sërë procesesh, Komisioneri ka sjellë vendimin: "Duke marrë parasysh cenimin e nenit 1 dhe në mbështetje me të drejtat e parapara sipas nenin 2/1 C, Ju njoftojmë se pronari dhe botuesi i gazetës "Dita" është personalisht apo së bashku përgjegjës për pagimin e shumës prej 25 mijë DM. Pagesa e kësaj shume duhet të bëhet jo më vonë se 26 korrik të vitit 2000 me çek të vërtetuar. Moszbatimi i këtij sanksioni do të rezultonte me suspendimin e veprimtarisë së gazetës "Dita" përderisa të mos bëhej pagesa".¹⁷ Pas presioneve dhe gjobave, gazeta "Dita" ka ndërprerë punën 28 korrik 2000.

"Dita" informoi lexuesit e gazetës se ishte urdhëruar nga zyra e Komisionarit të Përkohshëm për Media që ta ndërpresë veprimtarinë e saj, e nëse nuk e bënte këtë, atëherë kjo do të ekzekutohej nga autoritetet ligjore. Artikulli e kontestonte pohimin e KPM se gazeta "Dita" kishte rrezikuar jetën e priftërinjve ortodoksë të asaj komune (Deçanit), e cila përmendet në artikullin e botuar më 4 korrik 2000.¹⁸

¹⁶ Manastiri i Deçanit është objekt kulti ortodoks i shek. XIII, periudha Bizantine, që është njëherësh objekt kulturor i mbrojtur edhe nga Qeveria e Kosovës. Manastiri është edhe nën mbrojtjen e UNESCO-s.

¹⁷ Rasti Dita, Prishtinë. KMLDNJ, Prishtinë, f.220.

¹⁸ Po aty, f.121.

Transformimi postkonfliktual i shoqërisë në kontekst të rolit të medias, nuk ishte krejt i lehtë për sigurinë e medias dhe të gazetarëve. Idetë dhe faktet që paraqesin ndryshim nga gjykimi komunitar publik janë shoqëruar me reagime dhe probleme. Në Kosovë ndryshon edhe vlerësimi nga shoqëritë e tjera poskonfliktuale lidhur me rolin e medieve të pavarura. Kishte zëra kritikë, por jo sa të stigmatizonin medien e pavarur sikurse në Kroacinë poskonfliktuale, që jepet në një dokument të Komitetit të Helsinkit. Mediet e pavarura veçmas janë sulmuar dhe paditur nga liderët partiakë, akuzohen se janë kundër popujve të tyre. Mediet më të rëndësishme janë sulmuar se janë të paguara nga faktorët ndërkombëtarë dhe të dirigjuara nga të huajt, si dhe janë pjesë e puçit të bashkësisë ndërkombëtare kundër partive nacionale.¹⁹

Përmbyllje

Kosova mbas vitit 1999 ishte një shoqëri tipike postkonfliktuale. Kontradiktat sociale, politike dhe kulturore, konfrontuan ndërgjegjen e fajësisë dhe faljes, duke instaluar paqen publike në komunikime mediale. U përjashtua gjuha e fyerjes dhe nxitjes së dhunës etnike. Ajo nuk ekziston në formën e gjuhës së urrejtjes dhe nënçmimit mbi baza të diferencave etnike. Raportet e viteve 2006-2008 të Këshillit të Medies, organ për shqyrtimin e ankesave ndaj medias, tregojnë se nuk kishte në asnjë rast ankesa të qytetarëve apo institucioneve për fyerje apo atakim mbi baza etnike.

Mediet kanë rolin e tyre pse Kosova nuk u trondit nga dhuna dhe konfliktet postkoloniale. Ato promovuan shoqërinë me vlera demokratike, duke provuar të ruajnë balansin ndërmjet humanes dhe profesionale.

Gazetaria e tillë ka pasur lëshimet, duke u shërbyer me burime të shumta të lajmeve për veprimtarinë e institucioneve, UNMIKU-n, KFORIN, partive politike, udhëheqësve, zyra ose zyrtarë për informim.

¹⁹ Doc. Deklaratë e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, 2001, www.nh-hchr.org

Mbas normës së paskonfliktit (1999-2006), institucionet e Kosovës dhe ato ndërkombëtare krijuan normë ligjore, e cila garantoi lirinë më të plotë të shtypit, bazuar në praktikat e vendeve me demokraci në tranzicion. Përmes kësaj norme tani rregullohet puna e mbi 100 medieve elektronike, dhjetëra gazetave të përjavshme, mujore e periodike dhe nëntë gazetave të përditshme.

Bibliografia

- Berisha, Ibrahim: Mediet dhe tranzicioni, AAB, Prishtinë 2007.*
Fuga, Artan: Ikja nga kompleksi i Rozafës, Prishtinë, 2001.
Jakubowicz, Karol. Media in Transition, London, Routledge, 2001.
Paçarizi, Rrahman: Radiogazetaria, AAB, Prishtinë, 2008.
Prajs E. Monro, Reboj, Mark: Shërbimi Publik në vendet e tranzicionit, Beograd, 2002.
Karlsrajter, Ana: Mediet dhe shoqëritë, OSBE, Vjenë, 2003.
Raboy, Marc: The Hybridization of Public Broadcasting, UNESCO, Publishing, 1997.
Krasniqi, Milazim: Në çfarë Kosove do të jetojmë, Zëri ynë, Prishtinë, 2008.
Kval - Mellbye - Tranoy: Politika dhe demokracia, Rozafa, Prishtinë, 2007.
Grup autorësh: Televizioni në Evropë - rregullimi, politikat, pavarësia, Instituti i Shoqërisë së Hapur, Tiranë, 2005.
Doc. Raporti vjetor i RTK-së, 2006-2007.
Doc. Përkrahja për zhvillimin e shërbimit publik të transmetuesve në Kosovë, Prishtinë, mars 2003.
Deklaratë e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, 2001.
Çështja Dita, Prishtinë. KMLDNJ, Prishtinë 2001.
Ligji për RTK-në, Prishtinë, 2006.
IREX: Mediet dhe politika në Kosovë, Prishtinë, 2004.
Javno produzece RTV Crne Gore, statut RTV CG, Podgorica, 2003.
Casopis Danas, Beograd, 20 janar, 2008.....
Kodi i Përkohshëm i Sjelljes për Imediat e Shtypura në Kosovë, Prishtinë, 2006.
Korniza Kushtetuese e Kosovës, Prishtinë, 2008.
Rregullorja 2000/37. Prishtinë, 2000.
Rregullorja 2000/36, Prishtinë, 2000.

